# K O N T R A T E

## E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## " VLLAZNIMI " SH.P.K.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " Vllaznimi " shpk, përfaqësuar nga Z.Ylvi Mashi, Ylli Llapi dhe Sali Haxhagiq është person juridik me qëndër në Shkodër.

N E N I 1

Të sipërpërmendurit ranë dakort të themelojnë shoqërinë me emërtimin " Vllaznimi" shpk, me seli në lagjen Peresh Shkodër, rruga Alçi Kondi.

N E N I 2

Shoqëria "Vllaznimi"shpk është person juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas legjislacionit Shqiptarë në fuqi. Kontratës dhe Statutit.

N E N I 3

Shoqëria "Vllaznimi" shpk do të ushtrojë aktivitetin e saj për një peri udhë të papërcaktuar, por palë: pjesmarrëse kanë të drejtë ta rinovojnë.

N E N I 4

OBJEKTI I SHOQËRISË ËSHTË :Projektimi dhe zbatimi, në kadegoritë e spe cifikuara të punimeve.

a) Projektim i ndërtimeve civile, deri në dy kate, kadegorisë së dytë.

b) Zbatim te:

1. Kat.1- Punime dheu, murature, betoni, betonarme të zakonshme, pu nime shëmbjesh.

2. Kat.2-Ndërtime civile industriale, turistike, bujqësore etj dhe kompletimin me instalimet e nevojshme për to.

3. Kat.3- Punime restaurimi.

4. Kat 9/a - Ujësjellëse , kanalizime.

c) Tregëtim me shumicë dhe pakicë, import ekspoort, artikuj industrial ushqimorë, materiale ndërtimi , makineri etj.

N E N I 5

KAPITALI THEMELTAR i shoqërisë është 150.000 lekë i ndarë në kuota ndër- mjet ortakëve.

YLVI MASHI - Drejtor ekzekutiv, disponon një shumë prej 50.000 lekë

Ylli Llapi - Administrator, disponon një shumë prej 50.000 lekë.

Sali Haxhagiq -Administrator, disponon një shumë prej 50.000 lekë.

N E N I 6

Rregullat e shoqërisë janë përcaktuar në statutin bashkngjitur kon tës.

N E N I 7

Drejtimi i shoqërisë " Vllaznimi " shpk do të bëhet nga Z. Ylvi Mash i cili do të jetë drejtor ekzekutiv i shoqërisë, ndërsa Ylli Llapi dhe Sali Haxhagiq administrator të shoqërisë.

N E N I 7/a

Të tre ortakët janë administrator të shoqërisë.

./...

NENI 8

Përfaqesimi i shoqerise " VLLAZNIMI " SHPK,para te treteve,para çfardo organ shteteror,para Bashkise se Tiranes e ne qytete te tjera te Shqiperise,para bankave, para arbitrazhit dhe organeve gjyqesore,kryhet nga drejtori ekzekutiv i saj Z.Ylvi Mas

Né rast té mungesés sé tij,ai me prokure té veçante ose té pergjithshme,mund té emérojé një person té zgjedhur sipas déshires.

NENI 9

TE DREJTAT E ORTAKEVE :

- Té administrojé aktivitetin e shoqerise "VLLAZNIMI" SH.P.K.mé perputhje me aktin e themelimit dhe statutin bashkengjitur kesaj kontarte.

- Pjesmarrjen ne rezultatet e çfarde forme dhe sasije te aktivitetit te Shoqer "VLLAZNIMI" SHPK, te parashikuara ne dokumentat e themelimit.

- Grumbullimi i te dhenave mbi situaten ekonomike e tregetare teShoqerise "VLLAZNIMI" SHPK e mbi té gjithe dokumentet.

- Paraqitja e propozimeve dhe vleresimi i tyre nga ana e ortakéve.

- Ortakét kane te drejte t é heqin dore nga kjo kontrate duke e njoftuar njeri tjetrin 1 (njé) vit perpara,duke pasqyruar edhe arsyet e heqjes dore.

- Terheqja e nje ortaku nga Shoqérija "VLLAZNIMI" SHPK mund te behet duke tras- feruar kuoten e tij nje ortaku tjeter,e ne rast mos pranimi, sipas rregullave qe do te mé statut,ai ka te drejte tja shese njé té treti.

NENI 10

DETYRIMET E ORTAKEVE :

- Té likujdojne kuoten per themelimin e kapitalit baze dhe shtesat e mundeshme qe mund t'i shtohen atij kapitali,kur njé gjé e tille gjykohet pozitivisht nga ortaket.

- T'i siguroje shoqerise "VLLAZNIMI" SHPK te dhenat e nevojshme per perpunimin e çdo objektivi,te lidhur me aktivitetin e Shoqerise.

NENI 11

Né rast vdekje,ose largimi me deshire,ose i perjashtuar me 2/3 e votave te ortakve,Shoqeria " VLLAZNIMI" vazhdon aktivitetin e saj,duke likujduar ortakun qe nuk e ma me vlere leku,pasi behet bilanci dhe te miratohet nga ortaket ose trashgimtaret e ti

NENI 12

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE :

Mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise,do te zgjid me mirkuptim te paleve,te cilet caktojne nga nje perfaqesues,Kur mirkuptimi s'eshte i m palet i drejtohen Gjykates sé Tiranes,vendit ku realizohet kjo kontrate.

Y. Mashi

**Palet mbasi lexuam materialin e mesiperm dhe pasi gjetem te formuâmar sipas vullnet te tyre té liré e té ploté,firmosén ate sipas ligjit.**

XEEW YLVI MASHI — YLLI LLAPI — SALI HAXHAGIQI

REPUBLIKA E SHQIPERISE — Nr. ........4280............Rep.

MINISTRIA E DREJTESISE — Nr. ........785............Kol.

N O T E R I A

## V E R T E T I M

Sot me daten 31.5 1994 (méntédhjeté e katér) ne Tirane,né zyren e noterise Tirané u paraqiten personalisht para meje noteree :Ylvi Mashi,Ylli Llapi dhe Sali Haxhagiq,prej meje tépanjohur pér identitetin e té ciléve u informova dokumentat e identifikimit qé ata mbanin,qé té tre madhoré me zotesi te ploté juridik pér té vepruar.

Ata deklaruan se kontrata e sipérme e redaktuar jashté késaj zyre,éshté sip vullnetit té tyre té liré e té plote dhe nénshkruan até rregullisht.

Uné noterja e gjej kété veprim né perputhje me ligjin,firmos rregullisht sipas ligjés.

N O T E R E

# STATUTI

# I

# SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

# " VLLAZNIMI " SH P K

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### NENI 1

SHOQERIA " VLLAZNIMI" SH P K KRIJOHET NGA ORTAKET

1. YLVI MASHI
2. YLLI LLAPI
3. SALI HAXHAGIQ

Në bazë të kriterëve të përcaktuara në ligjin Nr 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqeritë tregtare" dhe Kodin Tregëtar të Republikës së Shqiperisë.

### NENI 2

Shoqeria "VLLAZNIMI" sh p k ushtron veprimtarine e saj ne baze të ekonom[...] së tregut të lirë.

### NENI 3

Ortakët themelues në këtë sipermarrje kane derdhur kapitalet e tyre,me qëllim që të përfitojne të ardhurat që mund të vijnë nga veprimteria private e shoqerisë "VLLAZNIMI" shpk,si dhe perballejne humbjet deri në kufirin e vleres së kontributit në kapitalin themeltar.

### NENI 4

Shoqeria " Vllaznimi" shpk është person juridik dhe fiton zotësinë për t[...] vepruar me rregjistrimin në gjykaten e rrethit Tiranë dhe paisjen me leje te ushtri[...] të profesionit nga Zyra e Tatimeve e Rajonit përkatës.

## EMRI, SELIA, TERITORI

### NENI 5

EMERTIMI I SHOQERISE DO TE JETE:

SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "VLLAZNIMI" SHPK SHKODER

### NENI 6

Selia e shoqerisë do të jete në lagjen "Alqi Kondi" Perash Shkoder.

Shoqeria e fillon aktivitetin e saj me seli në Shkoder në adresën e sip[...]

Shoqeria mund të zhvillojë aktivitetin e saj në të gjithë teritorin e Shqiperise dhe jashte saj.

### NENI 7

Aktiviteti privat i shoqerise "VLLAZNIMI" shpk do të zhvillohet me një [...] pa përcaktim,me të drejtë rinovimi.

## OBJEKTI

NENI 8

OBJEKTI I SHOQERISE :éshté projektim dhe zbatim ,né kategorite e specifikuar te punimeve.

a ) Projektim i ndertimeve civile,deri né dy katé,té kategorisé sé dyte.

b) Zbatim te :

1. Kat. 1 -Punime dheut,muraturé,betoni,beton arme té zakonshem, punime shémbjesh.

2. Kat. 2 -Ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore etj dhe kompletimin me instalimet e nevojshme pér te.

3. Kat. 3 - Punime restaurimit.

4. Kat. 9/a - Ujésjellsa,kanalizime.

Perveç veprimtarise ndertimore,projektuese tregton me shumice dhe pakice materiale ndertimi,industriale,ushqimore,minerale,trasport,turizem, paisje elektroshtepiake,makineri si dhe objekte té pergjithshme te veprimtarise se saj.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 9

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE éshté :150.000 leke i ndare me kuota ndermjet ortak

YLVI MASHI. Drejtor ekzekutiv i shoqerise,disponon njé shumé prej 50.000 leke (pesédhjetémijé) leke e nenshkrueshme dhe e shlyeshme prej tuj.

YLLI LLAPI .Administratori i shoqeriseé disponon njé shumé prej 50.000 ( pesédhjetemije) leke e nenshkrueshme dhe e shlyeshme prejtij.

SALI HAXHAGIQ, - perfaqesues i shoqerise,disponon nje shume prej 50.000 (pesedhjete mije ) leke e nenshkrueshme dhe shlyeshme prej tij.

NENI 10

Kapitali themeltar mund té rritet me shtimin e aktivitetit té shoqer " VLLAZNIMI" shpk. Zvogélimi i kapitalit themltar nén vleftén 100.000 leke e detyre shoqerine " Vllaznimi" shpk té shndrohet né njé formé tjeter né rast se ajo nuk mer vendim per rritjen e kapitalit deri me vleften e mesiperme.

NENI 11

Me pelqimin e ortakeve themelues pjeset kapitalit themeltar jane té traseferushme,me rruge trashégimie ose personave te tjeré qé nuk béjné pjese né sho " VLLAZNIMI" shpk.

NENI 12

Né rast té shtimit té ortakévé,pjese té kapitalit mund té trsferohen me pélqimin e tyre(té shumicés)né rast se ata perfaqesojne 3/4 e kapitalit themltar Trasferimet e kapitalit te vertetohen me akt noterial.



N E N I 13

Në rast vdekje të njërit prej ortakëve trashëgimtarët e ligjshëm nuk mund të marrin pjesë më në aktivitetin e shoqërisë " Vllaznimi " pa pëlqimin e ortakëve, kurse kapitali do t'i ndahet në vleftë leku propoeionalisht në bazë të dokumentave përkatëse që disponon shoqëria "Vllazni

DREJTIMI ADMINISTRATIV

N E N I 14

Shoqëria "Vllaznimi" shpk Shkodër do të drejtohet nga Z. Ylvi Mashi ( drejtor ekzekutiv dhe nga administratorët Ylli Llapi dhe Sali Hazhagiq. Ortakët themelues " Vllaznimi " shpk kanë kompetencë të caktoj në si administrator edhe persona të tjerë të cilët nuk kanë cilësinë e ortakut.

N E N I 14/a

Të tre ortakët janë administrator të shoqërisë.

N E N I 15

Drejtori ekzekutiv ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e v eprimtarisë së shoqërisë "Vllaznimi" shpk. Ai mund të kryej të gjitha v eprimet e administrimit në interes të shoqërisë " Vllaznimi " shpk.

N E N I 16

Në mardhëniet me drejtorin ekzekutiv r angazhon shoqërinë " Vllanimi" nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

N E N I 17

Asambleja e ortakëve si organi më i lartë vendimtarë i shoqërisë ka kompetencë të miratojë programin e shoqërisë " Vllaznimi " shpk, të hartojë raportin e asministrimit, inv entarët dhe llogaritë vjetore.

Të vendosi edhe shpërbërjen e shoqërisë.

Të vendosë për ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.

Të rregullojë mardhëniet e punësimit dhe të shpërblimit brënda shoqërisë " Vllaznimi " shpk.

Sipas akteve ligjore të bëjë shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shtetërore, personave juridik ose fizik vendas ose të huaj.

N E N I 18

Drejtori ekzekutib ka të drejtë të informohet për veprimtarinë e shoqërisë, si dhe të njihet me dokumentat e saj dhe llogaritë përkatëse në rast se këto mbahen nga persona të tjerë të c aktuar prej tij.

N E N I 19

Administratori e humbet detyrën e tij në rast të prishjes së shoqëris kur është i zgjedhur, kur shkarkohet nga asambleja e ortakëve themelu

K R E U II

MARDHENIET FINANCIARE

N E N I 20

Shoqëria "Vllaznimi"shpk mund të lidhë kontratë me sektorë shtetëror

./...

drejte perdrejte me tregun e lire, si dhe persona fizike e juridik vendesa ose te huaj

N E N I 21

Ne veprimet kontarktuale shoqeria "Vllaznimi" shpk perfaqesohet drejtor ekzekutiv i saj ose persona te tjere te caktuar prej njerit prej ortakeve themelues drejtat dhe detyrat qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine.

N E N I 22

Shoqeria "Vllaznimi" shpk pergjigjet per kontributin fiskal afatet e derdhjes se tij.Ajo ka te drejte te çele llogari likujduese prane bankave te vendit dhe te kryej veprimet likujduese nepermjet tyre.

N E N I 23

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike shoqeria "Vllaznimi" shpk ka te te vete financohet me leke ose valute te huaj.

N E N I 24

Per pasqyrimin e aktivitetit privat administratori ose personate tjere te caktuar prej tij jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe rregjistrave per katese sipas ligjit.

N E N I 25

Administratori ose persona te caktuar jane te detyruar te paraqesin bilanc vjetor dhe deklaraten e te ardhurave dhe ti depozitojne organin financiar te juridiksionit perkates .

K R E U III

MARDHANJET E PUNESIMIT

N E N I 26

Mardhanjet e punesimit brenda shoqerise rregullohet sipas kontrates punes qe lidhen midis palve ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

N E N I 27

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet me baze te nje akti te leshuar me shkrim nga administratori.Largimi lidhet me mbarimin e kontrates per shkelje disiplinore ose me kerkesen e te punesuarit (dhe pasi jane shlyer detyri materiale qe ka prane firmes.

~~N E N I 28~~

BILANCI DHE TE ARDHURAT

N E N I 28

Pas shlyrjes se detyrimeve fiskale detyrimet e tjera ndaj shtetit sigurimet shoqerore etj te ardhurat kalojne ne pronesi te ortakeve .

HUMBJA E SE DREJTES SE ORTAKERISE

NENI 29

Ortaku e humbet te drejten e ortakerise kur:

- Kerkon vete largimin e tij nga shoqeria " VLLAZNIMI" shpk .
- Kur perjashtohet me vendim te ortakeve themelues ose me shumice 2/3 e ortakeve te shoqerise,thyrje te perseritur te displines ne pune,abuzime per pervetes te njeanshme ose te shoqerise,ne rast paaftesie ne pune si dhe shendetesore.

PERGJEGJESITE LIGJORE

NENI 30

Ortaket e shoqerise " Vllaznimi" shpk jane pergjegjes individualisht ose solidarisht ,sipas rastit,ndaj shoqerise "ose té tretéve" per shkelje ligjore,shkelje té statutit ,apo per faje té kryera gjate administrimit té shoqerise "Vllaznimi"shpk.

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJES

NENI 31

Mosmarrveshjet qé mund té lindin gjate veprimtarise se shoqerise"Vllaznim shpk do te zgjidhen me mirkuptim té paleve,té cilat pér kété qéllim mund té caktojne njé pérfaqésues me prokure.

Kur mirkuptimi s'eshte i mundur ,palet à drejtohen gjykates sé Tiranés.

NENI 32

Perea nuk éshté shprehur ne statut,gjithçka i referohet ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare ",veçanti dhe legjislacioni Shqiptare né pergjithesi.

Statuti éshté hartuar me vullnet te lire té palve dhe éshté firmosuar.

ORTAKET THEMELUES

| YLVI MASHI | YLLI LLAPI | SALI HAXHAGIQ |
|---|---|---|

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA

Nr. ....4280.... Rep.
Nr. ....785.... Kol.

VERTETIM

Sot me daten 31 5.1994 (nëntédhjete e kater),né Tirané,né zyren e noterisé Tirane,u paraqiten personalisht para meje noteres
Ylvi Mashi,Ylli Llapi dhe Sali Haxhagiqi,para meje té panjohur pér identititetin e u informova dhe nga dokumentat e identitetit qé ata mbanin,qé té tre madhore,me zote té ploté juridike pér té vepruar.Ata deklaruan se statuti i mésiperm i redaktuar jas kesaj zyre,éshte sipas vullnetit té tyre té lire e té ploté dhe e nénshkruar até rregullisht.

Une noterja e gjej kete veprim né perputhje me ligjén,e firmosur rregulli